



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2019:144688

Datë: 12.01.2022

Numri i dokumentit: 02597413

C.nr. 092/2019

2019:144689

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë Rr. “Lidhja e Pejës” Magji.Prishtinë pa nr., të cilën e përfaqëson E. S. i punësuar në “...” SHPK, Rr. ... kati II. Nr..., Prishtinë, kundër të paditurit S. K. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, për çështjen kontestuese Rimbursim i dëmit, pas mbajtjes së seancës, më datën 15.11.2021, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET**, në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, e ushtruar ndaj të paditurit S. K. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, me të cilën ka kërkuar Rimbursim Dëmi në vlerë prej 223.50€

**II. DETYROHET** paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë që të paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20€ në emër të taksës për padi, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

**A r s y e t i m i**

Paditësja me datë 24.04.2019 ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate, kundër të paditurit S. K. , lidhur me çështjen kontestuese Rimbursim i Dëmit me të cilin ka theksuar se ka ndodhur aksident i komunikacionit me datën 07.11.2016 në Kaçanik ndërmjet automjetit “...” me targa të regjistrimit ... të cilin e ngiste tani i padituri S. K., e nga ky aksident janë

shkaktuar dëme të dëmtuares Policisë së Kosovës të cilat dëme janë shkaktuar nga lëshimet e tani të paditurit.

Gjithashtu ka theksuar se e dëmtuara Policia e Kosovës është rimbursuar apo ka realizuar dëmin nga BKS-Prishtinë tani në cilësinë e palës paditëse, pasi që shkaktar i aksidentit tani i padituri me rastin e aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit dhe duke i paraqitur gjykatës ujdi gjyqësore të datës 16.02.2017 si dhe urdhërin e transferit të bankës të datës 27.03.2017, mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që ta miratojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë përfaqësuesja e paditëses ka qëndruar në tërësi pranë këtyre theksimeve dhe mbi të njëjtën bazë dhe në bazë të të njëjtave prova i ka propozuar gjykatës që t'a miratojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

I padituri nuk i'u ka përgjigjur ftesës së Gjykatës dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e as nuk ka kërkuar shtyrjen e shqyrtimit gjyqësorë edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa Gjykata këtë seancë e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palës paditëse e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara, -U lexua: Kopja e transferit të mjeteve të datës 27.03.2017, ujdi jashtëgjyqësore e datës 16.02.2017, kopjet e fotografive të automjetit të dëmtuar në dy fletë, raporti i aksidentit me numër 2016-CFT-673, kërkesa për kompensim të dëmit e datës 23.11.2016, raporti i oficerit i datës 07.11.2016, raporti i policit hetues i datës 07.11.2016, kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e datës 07.11.2016, konfirmimi i sigurimit i lëshuar me datë 29.12.2016, pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Ka ndodhur aksident komunikacioni më datën 07.11.2016 rreth orës 10:15 në Kaçanik, ku pjesmarrës kanë qenë vozitësi i automjetit "..."- me targa ..., të cilin e drejtonte S. K. (tani i padituri), i cili në momentin e aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, në këtë aksident si palë

e dëmtuar ishte Policia e Kosovës e cila njëherit ka realizuar dëmin nga ky aksident, por me asnjë provë nuk është vërtetuar përgjegjësjja e pjesëmarrësve në këtë aksident e rrjedhimisht lartësia e dëmit që rrjedh nga ky aksident. Prandaj kërkesat e tilla të pa përcaktuara nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe si të tilla gjykata i ka trajtuar si kërkesa të pabazuara.

a) Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 07.11.2016, ku në këtë aksident kanë marrur pjesë vozitësi i automjetit “...” me targa të regjistrimit ... – S. K. (tani i paditur) dhe në anën tjetër e dëmtuara Policia e Kosovës, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të raportit të aksidentit të datës 07.11.2016, dhe raportit të policit hetues të po të njëjtës datë, si dhe nga fotografitë e automjetit të dëmtuar (të cilat janë paraqitur në kopje me shiqim të dobët).

b) Faktin se në momentin e aksidentit të lartëcekur, vozitësi i automjetit S. K. ka drejtuar automjetin e tij pa mbulesë siguroese, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të Konfirmimi i Sigurimit i lëshuar nga Kompania “...” më datë 04.08.2015, me të cilën vërtetohet se validiteti i këtij sigurimi ka qenë nga data 04.08.2015, deri më datë 04.08.2016, me çka u vërtetua se në momentin e aksidentit i padituri nuk ka pasur mbulesë siguroese.

c) Faktin se ky aksident është shkaktuar me fajin apo me përgjegjësinë e të paditurit S. K., ashtu që gjatë gjithë gjykimit është pretenduar nga pala paditëse, gjykata me asnjë provë të prezentuar nga palët ndërgjyqëse nuk ka mundur t’u vërtetoj dhe ta konstatoj sepse gjatë gjithë procesit gjyqësorë palëve i’u është mundësuar të paraqesin prova për t’i vërtetuar faktet e pretenduara ndërsa këtë gjë nuk e kanë bërë palët ndërgjyqëse respektivisht pala paditëse si pretenduese e gjendjes faktike.

Gjykata e refuzoi kërkespadinë e paditëses në tërësi si të pabazuar për faktin se me asnjë provë nuk u vërtetua kërkespadia e paditëses si e bazuar, për shkak se gjendja e paraqitur nga pala paditëse nuk rezultoi të ishte në përputhje me asnjë provë të bashkangjitur në shkresat e lëndës e obligim i secilës është që pala paditëse të paraqesë prova për t’i vërtetuar faktet e pretenduara, kjo konform Nenit 7 paragrafi 1 i LPK-së ku thuhet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, andaj në kuptim të kësaj dhe në bazë të provave të administruara, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, rrjedhimisht gjykata nuk gjeti arsyeje për të aplikuar dispozita tjera konkrete të Ligjit mbi Sigurimin e

Detyrueshëm nga Autopergjegjësjja, pasiqë bazueshmëria e kërkesës rezultoi si e dështuar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila u vërtetua në mënyrë të plotë dhe të drejtë që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerra dhe të vlerësuara, gjykata vlerëson se janë eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendimmarrje dhe kërkesëpadinë e paditëses e refuzoi në tërësi si të pa bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse kemi të bëjmë me kontest të vlerës së vogël, palët ndërgjyqëse mundë të ushtrojnë ankesë vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës material, konform nenit 491.1 të LPK-së, këtë udhëzim gjykata e dha konform nenit 491.2 të LPK-së.

Gjykata e detyroi palën paditëse të paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20€ në emër të taksës për padi, të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**

**C.nr.92/2019 datë 15.11.2021**

**Gjyqtari:**

**Burhan BERISHA**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.